



Planuar / Dorezuar Prilijeno / Prudato Received / Delivered	13. 04 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSACK	2072	2022	115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.173/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.173/2022 të datës 28.02.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Shërbimi Sprovues i Kosovës, në çështjen juridike "Vlerësimi i punës për vitin 2021", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 13.04.2022 mori këtë:

**V E N D I M**

**I. ANULOHET** Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 31.01.2022 për ankuesin

**II. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmerre veprimet e nevojshme me qëllim që të bëhet vlerësimi për vitin 2021 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit që ka qenë në vitin 2021.

**III. OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës, që të ndërmarrë të gjitha veprimet për zbatimin e këtij vendimi.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën “Drejtor i Drejtoratit për Administratë” sipas Akt emërimit të datës 04.01.2018 në Shërbimin Sprovues të Kosovës/MD. Me datë 28.02.2022 është vlerësuar për tetë (8) muajt e fundit të vitit 2021 duke e vlerësuar ankuesin me notën e përgjithshme 4 ndërsa për periudhën janar-prill për vitin 2021 ankuesi nuk është vlerësuar.

I pakënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, ankuesi me datë 28.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 1021/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 04.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Shërbimi Sprovues i Kosovës /MD, ndërsa me datën 14.03.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova:** Ankesën me numër A.nr.1732022 me numër të protokollit 1021/2022 të parashtruar nga ankuesi me datën 23.02.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i vlerësimit për vitin 2021 i panënshkruar as nga vlerësuesi as nga i vlerësuar; Akt emërimi i datës 04.01.2018 për E-mail zyrtar i datës 14.02.2022-sqarim rreth vlerësimit 2021; E-mail zyrtar i datës 01.02.2022; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022; E-mail zyrtar i datës 04.02.2021; E-mail Zyrtar i datës 29.01.2021; E-mail zyrtar i datës 19.01.2022; Vendimi i datës 08.04.2021 me numër protokollit 01-364; Organogrami i Shërbimit Sprovues të Kosovës; Përgjigje në ankesë e datës 14.03.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 1491/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vlerësimi i rezultateve në punë i datës 28.01.2021; Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të emërimit i datës 23.05.2017; E-mail zyrtar i datës 14.02.2022; E-mail zyrtar i datës 01.02.2022; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022; E-mail zyrtar i datës 30.01.2022; E-mail zyrtar i datës 25.02.2022 dhe Fletëkthesa e datës 10.03.2022;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në *ri vlerësim, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, iu është bërë pa as një konsultim ose bisedë paraprake nga ana e eprorit të tij të drejtpërdrejt, pa nënshkrim të vlerësuesit, si dhe vlerësimin e rezultateve të punës e konsideron se është bërë nga organi jo kompetent sepse unë për pozitën që e kam Drejtor i Drejtoratit për Administratë i përgjigjem drejtpërdrejt Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave, pas analizimit të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 për ankuesin, ka konstatuar që ankuesi në ankesën e tij ka theksuar faktin që formulari i vlerësimit për periudhën Janar-Dhjetor për vitin 2021, e ka pranuar me datë 28.02.2022, ndërsa nga provat e dërguara nga organi i punësimit/Shërbimi

Sprovues i Kosovës/MD,në formularin e vlerësimit tek pjesa" komentet e të vlerësuarit në rast se është i pakënaqur me vlerësimin e objektivave dhe aftësi", del se ankuesi në këtë vlerësim nuk e ka vendosur nënshkrimin e tij e as datën se kur e ka pranuar të njëjtin, mirëpo i njëjti mban datën 31.01.2022 ndërsa formulari i gjeneruar në sistem të SIMBNJ më datë 01/02/2022. Ndërlidhur me këtë Kolegji konstaton se vlerësimi është bërë në kundërshtim me nenin 43 paragrafin 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: "1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e paracaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit" si dhe me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet se: "2. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin paraprak", e që në rastin konkret, ka qenë e pamundur për Kolegjin që të përcaktoj saktë datën se kur është kryer vlerësimi për ankuesin nga ana e Udhëheqësit të tij, kur i është dorëzuar ky vlerësim të njëjtit lidhur me dhënien e komenteve për pajtimin ose mos pajtimin e këtij vlerësimi dhe se kur është nënshkruar i njëjti edhe nga ana e ankuesit, ngase bazuar në dispozitat e lartcekura afati lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë duhet të bëhet deri me datën 31.01.2022 nga ana e udhëheqësit të drejtpërdrejtë të ankuesit dhe i njëjti ti dorëzohet ankuesit, andaj vlerësimi në rastin konkret për ankuesin si i tillë nuk konsiderohet se ka përfunduar,sepse zv.Drejtoresha e Përgjithshme me datë 30.01.2022 e autorizon zëvendës Drejtorin e Përgjithshëm që ta kryej vlerësimin përveq tjerëve edhe për ankuesin sepse zv.Drejtoresha e Përgjithshme ishte në pushim vjetor prej datës 19.01.2022 deri më datë 31.01.2022 e që gjatë kësaj kohe e ka zëvendësuar Drejtori i Drejtoratit të Administratës,ndërsa kolegji vlerëson se afati i vlerësimit është i rregulluar me nenin 8 paragrafi 2 i Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike,të specifikuar si më lartë,dhe se gjatë kësaj periudhe zv. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës, më konkretisht deri më datë 18/01/2022 ka qenë në punë dhe ka qenë obligim ligjor vlerësimi për vartësit e saj.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë nga ankuesi si dhe duke u kujdesur që sipas detyrës zyrtare të vlerësoj shkresat e administruara, ka analizuar paragrafin 2 të nenit 5 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku thuhet se: "2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimi vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues", rrjedhimisht në kuptim të kësaj dispozite ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se sipas Vendimit me numër protokolli 04-364 të datës 08.04.2021,është caktuar zv.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës ndërsa për periudhën Janar -Prill ankuesi fare nuk është vlerësuar nga eprori i tij i drejtpërdrejtë ,ndërsa vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej nga eprori i tij që ka qenë gjatë periudhës 01/01/2021 deri më 07/04/2021, ngase ka qenë obligim i tij ligjor, ndërsa për periudhën nga data 08.04.2021 deri më datën 31.12.2021 do duhej të bëhej nga

mbikëqyrësi pasues si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankuesit në këtë rast nga zv.Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Sprovues të Kosovës.

Lidhur me faktin se ankuesi nuk është vlerësuar për periudhën Janar Prill, ndërsa sipas Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, vlerësimi i rezultateve në punë për ankuesin deri në këtë periudhë do duhej të bëhej nga eprori i tij i drejtpërdrejtë konformë nenit 43 paragrafi 5, i cili paragrafë specifikisht parasheh "*Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse*", ngase ka qenë obligim i tij Ligjor ,andaj mbi këtë bazë është konstatuar se vlerësimi prej muajit Janar deri në Prill për vitin 2021 ankuesit nuk ju ka bërë dhe se është obligim Ligjor i zv.Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës që të ndërmerr veprimet me qëllim që të sigurohet që Drejtori i Përgjithshëm që ka qenë në cilësi të eprorit të ankuesit të bëjë vlerësimin për periudhën sa ka qenë eprorë i ankuesit, konformë dispozitave të potencuara më lartë .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 pa pasur asnjë takim paraprak nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se është i qëndrueshëm sepse mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, i cili përcakton se: "*Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.vlerësimin (notimi) e objektivave*", sepse vlerësimi i është dërguar ankuesit në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: "*Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit*", që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesi është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se ankuesi me datë 01.02.2022 ka kërkuar sqarim për vlerësimin e performancës në punë për vitin 2021 por nuk ka marrë përgjigje deri më datë 25.02.2022 duke e sugjeruar ankuesin që të ndërmerr veprime në pajtim me ligjin në fuqi, andaj Kolegji bazuar në Legjislacionin në fuqi obligon zv.Drejtorin e Përgjithshme të Shërbimit Sprovues të Kosovës që të bëjë vlerësimin e për periudhën Prill-Dhjetor 2021 pasi që e njëjta është mbikëqyrëse e drejtpërdrejt e i cili mban pozitën e Drejtorit të Drejtoratit të Administratës në Shërbimin Sprovues të Kosovës, ndërsa poashtu obligohet që të ndërmarrë veprimet me qëllim që të sigurohet që të bëhet vlerësimi edhe për periudhën Janar-Prill -2021 nga eprori i tij i drejtpërdrejtë që ka qenë në këtë periudhë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit i cili ka pretenduar se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 nuk është bërë nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt si organ kompetentë dhe është vlerësuar me notën 4 kurse vlerësimi



për vitin 2020 ka qenë me notën 4.65,ndërsa kolegji ka konstatuar se qëndron si i bazuar ky pretendim sa i përket organit kompetentë të vlerësimit nga se ankuesi direkt i raporton drejtorit të përgjithshëm dhe kjo argumentohet edhe përmes komunikimeve zyrtare e më konkretisht emailit të datës 30/01/2022,si dhe organogramit që kemi në shkresat e lëndës andaj mbi këtë bazë eprori aktual i specifikuar më lartë është i obliguar që ankuesit ti bëjë vlerësimin e rezultateve të punës për periudhën 08/04/2021 deri më 31/12/2021, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerre të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankuesit të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil dhe poashtu të kujdeset që të bëhet vlerësimi edhe për periudhën Janar-Prill -2021 nga eprori i tij i drejtpërdrejtë që ka qenë në këtë periudhë konformë bazës ligjore të specifikuar më lartë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda,A.nr.173/2022, datë 13.04.2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Sprovues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së,

